



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije Lokalne Samupravo
Ministry of Local Government Administration

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

UDHËZUES PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave

Prishtinë, nëntor 2013

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL | Udhëzues për Liberalizimin e Vizave



HYRJE

Udhëzuesi për Liberalizim të Vizave ka për qëllim të informoj dhe orientoj institucionet e nivelit lokal lidhur me këtë proces. Dihet mirëfilli se lëvizja e lirë e qytetarëve është nga parimet themelore të lirive dhe të drejtave të njeriut. Gjithashtu, lëvizja e lirë e qytetarëve është vlerë thelbësore e shoqërisë evropiane dhe zhvillimit të saj në të gjitha stadet jetësore. Në këtë kontekst, për të pasur lëvizje të lirë të qytetarëve, një shtet duhet të ketë stabilitet politik dhe zhvillim ekonomik, siguri publike, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim me shtetet e rajonit. Këto janë elementet kryesore që determinojnë një shtet për tu integruar në familjen evropiane. Po ashtu, nëse i referohemi vlerësimeve të hartuesve të politikave dhe analistëve të ndryshëm, këta të fundit procesin e liberalizimit të vizave e vlerësojnë si “ **mekanizëm të fuqisë së butë të BE-së**”, ku BE si përcaktues i kushteve dhe kriterëve, dëshiron të përfshijë dhe të sjellë ndryshime në rajonin e trazuar të Ballkanit.

DIALOGU DHE MARRJA E VEPRIMEVE LIDHUR ME PROCESIN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

Duke pasur parasysh gamën e gjerë të çështjeve që janë të ndërlidhura me liberalizimin e vizave dhe nevojën për krijimin e një konteksti të sigurt në mënyrë adekuate për udhëtim pa viza, ky udhëzues ka për qëllim të identifikojë legjislacionin dhe të gjitha masat tjera që Kosova duhet t'i miratojë dhe zbatojë, si dhe, kushtet që duhet të përmbushen në periudhën afatshkurtër për avancimin drejt liberalizimit të vizave. Dialogu për liberalizimin e vizave do të adresojë katër grupe të çështjeve, si: **siguria e dokumenteve, menaxhimi i kufirit/kufirit administrativ dhe migracionit, siguria dhe rendi publik dhe të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes.**

Ky dialog do të përshtatet për t'i mundësuar Kosovës të fokusojë përpjekjet për reforma dhe të plotësojë parakushtet e BE-së. Shpejtësia e lëvizjes drejt liberalizimit të vizave do të varet nga arritjet e Kosovës në miratimin dhe zbatimin e masave dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë udhëzues.

Dialogu për liberalizimin e vizave, si pjesë e politikës së përgjithshme të BE-së për Ballkanin Perëndimor, do të realizohet në kuadër të Dialogut për Procesin e Stabilizim-Asociimit. Kjo do të kryhet nga zyrtarë të lartë të cilët mund të vendosin për organizimin e takimeve teknike të nivelit të ekspertëve për çështje specifike. Progresi i arritur për çështjet e mbuluara nga dialogu për liberalizimin e vizave do të raportohet në kuadër të Dialogut për Procesin e Stabilizim-Asociimit.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) në pajtim me mandatin që ka, do të ketë një rol të rëndësishëm në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e institucioneve të Kosovës për miratimin dhe zbatimin e reformave dhe përmbushjen e kërkesave të caktuara në këtë udhërrëfyes. Bashkëpunimi efektiv i autoriteteve të Kosovës me EULEX-in, përfshirë edhe përmbushja e mandatit të tij ekzekutiv, do të jetë thelbësor.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të përcaktuara në Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, Komisioni do të paraqes një propozim para Parlamentit Evropian dhe Këshillit për heqjen e obligimit për viza për qytetarët e Kosovës, përmes një plotësim-ndryshimi të Rregullores së Këshillit (EC) 539/2001. Pa paragjykim ndaj qëndrimeve të shteteve anëtare për statusin në kohën e propozimit, Komisioni mund të shqyrtojë propozimin për të transferuar Kosovën nga Pjesa 2 e Aneksit I në pjesën e përkatëse të Aneksit II të kësaj Rregulloreje. Ky propozim do të mbulojë vetëm bartësit e dokumenteve biometrike të udhëtimit. Në pajtim me nenin 77(2)(a) të Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli vendosin në pajtim me procedurat e zakonshme legjislative.¹

¹ Liberalizimi i Vizave me Kosovën, Udhërrëfyes;

ÇKA PËRFSHIN PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE ?

Plani i Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave përfshin kriteret gjithëpërfshirëse dhe aktivitetet që ndërlidhen me punën e institucioneve vendore. Institucionet vendore janë përgjegjëse për zbatimin e kriterëve dhe rekomandimeve, duke bashkëpunuar ndërmjet vete dhe në partneritet të vazhdueshëm me faktorët ndërkombëtarë të cilët veprojnë në Kosovë, në këtë rast duke përfshirë Komisionin Evropian, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX-in dhe projektet mbështetëse. I tërë ky proces ka dalë si rezultat i raportit të parë vlerësues të Bashkimit Evropian për zbatimin e këtij Udhërrëfyesi. Gjithashtu, vlen të theksohet se Plani i Veprimit është hartuar nga të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces, vendor dhe ndërkombëtarë, të cilët janë angazhuar në fushat që mbulohen nga procesi i liberalizimit të vizave, me theks të veçantë në fushën e sundimit të ligjit dhe respektimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Plani i Veprimit përbëhet nga pjesa narrative dhe tabela e veprimeve. Veprimet janë të ndara sipas blloqeve, ku përfshihen:²

- **Blloku 0: Ripranimi dhe riintegrimi – 28 veprime;**
- **Blloku 1: Siguria e dokumenteve – 10 veprime;**
- **Blloku 2: Menaxhimi i kufirit dhe i migracionit – 46 veprime;**
- **Blloku 3: Siguria dhe rendi publik - 66 veprime; dhe**
- **Blloku 4: Të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes – 14.**

Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave është rreth 19,158,000€. Përveç kësaj, një pjesë e konsiderueshme e koston është e mbuluar me kosto administrative, respektivisht ajo e dedikuar për paga e mëditje, hapësirat e pajisjet ekzistuese, e të cilat tashmë janë të llogaritura në buxhetin e secilit institucion, dhe prandaj nuk janë llogaritur ndaras, por janë evidente si **“kosto administrative”**. Sa i përket kornizës ligjore dhe politikave, në kuadër të Planit të Veprimit është paraparë hartimi dhe ndryshim – plotësimet, si dhe azhurnimi i një numri të konsiderueshëm të akteve legjislative dhe dokumente të politikave. Në këtë drejtim, fokus i është dhënë më shumë akteve nënligjore ekzistuese të cilat do të rishikohen, ku përmes tyre do të reflektohet në ligjet përkatëse.³

² *Plani i Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, faqe 5;*

³ *Plani i Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, faqe 6;*

CILAT JANË OBLIGIMET E MAPL-së QË NDËRLIDHEN ME PLANIN E VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE NË RAPORT ME NIVELIN LOKAL?

Procesi i integritimit të Kosovës në BE dhe detyrimet që dalin nga ky proces, kryesisht kanë të bëjnë me demokratizimin, sundimin e ligjit, si dhe përafrimin e adaptimin e legjislacionit me atë të BE-së (Acquis Communautaire). Për së afërmi, Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave kërkon nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal për të arritur progres në çështjet që lidhen me ri-pranimin dhe ri-integrimin, sigurinë e dokumenteve, menaxhimin e kufijve dhe politikat e migracionit, duke përfshirë sigurimin e qëndrueshëm të rendit dhe të sigurisë publike, si dhe lirinë e lëvizjes. Në këtë drejtim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si organ mbikëqyrës i komunave është e përkushtuar për të përmbushur obligimet e saja karshi proceseve integruese në raport me nivelin lokal të qeverisjes. Një theks i veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të vetëdijesimit të përgjithshëm publik dhe të kthyerve lidhur me kthimin, riatdhesimin dhe riintegrimin.

Në këtë kontekst, MAPL, në bazë të përgjegjësiave që i takojnë dhe me qëllim të mbështetjes së nivelit lokal, ka identifikuar disa detyra të cilat kërkohej të përmbushen në Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, në fushat si:

1) Ngritja e kapaciteteve për riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivelin lokal dhe qendror - duke përfshirë: numrin e zyrtarëve shtesë të punësuar në Departamentin për Riintegrim, numri i zyrtarëve shtesë të punësuar në komuna dhe numri i trajnimeve të ofruara zyrtarëve përgjegjës për riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivelin qendror dhe lokal;

2) Zhvendosja e fokusit nga programi për riintegrim emergjent tek shërbimet e riintegritimit të qëndrueshëm - duke përfshirë: kryerjen e një vlerësimi të nevojave për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, numri i kurseve të gjuhës të ofruara nxënësve dhe studentëve të riatdhesuar, numri i personave të riatdhesuar të përfshirë në trajnime profesionale;

3) Zotimi dhe shpërndarja e fondit të riintegritimit - shuma e mjeteve financiare nga fondi të zotuar dhe të shpenzuara nga secila kategori të shërbimeve emergjente për vitin 2013, shuma e mjeteve financiare nga fondi të zotuar dhe shpenzuara për secilën kategori të shërbimeve të riintegritimit të qëndrueshëm për vitin 2013;

4) Ngritja e numrit të përfituesve nga programi i riintegritimit - duke synuar numrin e përfituesve për secilën kategori të shërbimeve i përcaktuar (bazuar në vlerësimin e nevojave për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar);

5) Zbatimi i kodit të etikës në Komuna – parashikimi i nevojës për të pasur një kod të mirësjelljes në të gjitha komunat, me qëllim të ngritjes dhe sigurimit të një niveli më të madh të përgjegjësisë dhe etikës brenda shërbimit civil;

6) Të drejtat e njeriut në nivelin lokal – në këtë fushë, komunat raportojnë në baza periodike për zbatimin e të drejtave të njeriut. Përkundër rolit mjaft aktiv të Njësive për të Drejtat e Njeriut në komuna, parashikimi i nevojës për të pasur një buxhet më të madh dhe një kod buxhetor të veçantë është i domosdoshëm për njësinë.

7) Fuqizimi i Zyrave Komunale për Kthim dhe Komunitete – në këtë drejtim, ngritja e kapaciteteve dhe aftësive të zyrtarëve komunal për të qenë më efikas dhe më efektiv në përmbushjen e obligimeve të tyre.

8) Funkcionalizimi i KKSBB-ve në Komuna - në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi

CILAT JANË KUSHTET QË DUHET PLOTËSUAR PËR TË PASUR NJË REGJIM PA VIZA PËR KOSOVËN?⁴

I. Kushtet lidhur me ri-pranimin dhe ri-integrimin

Ri-pranimi - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: vazhdimin e zbatimit të legjislacionit vendor për fushën e ri-pranimit, zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese për ri-pranim, sigurimin e procedurave të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe kthimin e qytetarëve të Kosovës, sigurimin e procedurave për ri-pranim, fuqizimin e kapaciteteve të autoriteteve kompetente për procedimin e aplikacioneve për ri-pranim, sigurimi i aplikacioneve për ri-pranim, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme për ri-pranim tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it.

Ri-integrimi - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: miratimin dhe zbatimin e masave për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësisë të autoriteteve kompetente për ri-integrim, zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për ri-integrim, hartimin dhe komunikimin me kohë të statistikave të hollësishme për ri-integrimin e të kthyerve, te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-

⁴ <http://www.visalib.info>

II. Kushtet lidhur me sigurinë e dokumenteve; menaxhimin e kufirit/kufirit administrativ; rendit dhe sigurisë publike; dhe të drejtat themelore për sa i përket lirisë së lëvizjes

BLLOKU 1: Siguria e dokumenteve

Dokumentet personale të udhëtimit, letërnjoftimet dhe dokumentet sekondare - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: lëshimin e dokumenteve personale biometrike të udhëtimit të lexueshme nga makina (kompjuteri) në pajtueshmëri me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC) dhe standardet e BE-së për shenjat e sigurisë, miratimin dhe zbatimin e masave për garantimin e integritetit dhe sigurisë të procesit të gjendjes civile dhe regjistrimit civil, miratimin dhe zbatimin e masave që garantojnë integritetin dhe sigurinë e procesit të aplikimit për dokumente, lëshimit dhe shpërndarjes, miratimin dhe zbatimin e masave që garantojnë integritetin dhe sigurinë e dokumenteve sekondare, raportimin nëpërmes kanaleve përkatëse në bazën e të dhënave të Interpolitit LASP, fuqizimin e kapaciteteve të agjencisë së regjistrimit civil për kryerjen e detyrave të saj, mbajtja e programeve trajnuese lidhur me anti korrupsionin dhe vendosjen e një kodi të etikës për zyrtarët e përfshirë në procesin e regjistrimit civil, aplikimit për dokumente dhe shpërndarjes, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme mbi numrin e lëshuar të dokumenteve personale të udhëtimit dhe letërnjoftimeve, përfshirë letërnjoftimet tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it .

BLLOKU 2: Menaxhimi i Kufirit/kufirit administrative dhe migracionit

Menaxhimi i kufirit/kufirit administrativ - Në bashkëpunim me EULEX-in dhe KFOR-in, Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: harmonizimin me *acquis* të BE-së dhe të zbatojë legjislacionin mbi menaxhimin e integruar të kufirit/kufirit administrativ (MIK), zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese bilaterale në fushën e menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ, Protokollin Teknik për zbatimin e konkluzioneve të arritura për MIK të dialogut të 2 dhjetorit 2011, përpjekje për përfundimin e demarkacionit të kufirit/kufirit administrativ me Malin e Zi, miratimi dhe zbatimi i strategjisë së re për MIK dhe planin e veprimit, përmirësimi i kontrollit të kufirit/kufirit administrativ (ndalimet dhe vëzhgimet) në dhe ndërmjet pikave të kalimit të kufirit/kufirit administrativ, ndërtimi i pikave të përbashkëta të kalimit të kufirit/kufirit administrativ për kontroll dhe vëzhgim të koordinuar të personave, veturave dhe mallrave që kalojnë kufirin/kufirin administrativ, rritja, parandalimi, zbulimi dhe hetimi i krimeve të rënda ndërkufitare, posaçërisht trafikimi i qenieve njerëzore, lehtësimi i migracionit të parregullt, trafikimi i narkotikëve dhe prekursorëve, trafikimit i armëve dhe krimeve të kryera nga grupe endacake kriminale, fuqizimi i kapaciteteve të qendrës koordinuese vendore për koordinimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet autoriteteve vendore të përfshira në MIK, shtimi i bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në MIK, përmirësimi i qasjes tek të gjitha autoritetet kompetente të përfshira në MIK në sistemin ekzistues të menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ dhe të dhënat e proceduara nga qendrat

nacionale koordinuese, mbajtja e programeve trajnuese në fushën e kundër korrupsionit dhe luftimit të krimit të organizuar, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme lidhur me masat e kontrollit të kufirit/kufirit administrativ, duke përfshirë numrin e koordinuar të monitorimit dhe operacioneve patrulluese, tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it, hulumtimi i modaliteteve të bashkëpunimit me FRONTEX.

Përgjegjësitë e transportuesve - Kosova duhet t'i përmbushë këto kushte: miratimin dhe zbatimin e masave që përcaktojnë përgjegjësitë ligjore të transportuesve.

Menaxhimi i migracionit - Kosova duhet të përmbushë këto kushte: Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për migracionin legal në pajtueshmëri me *acquis* e BE-së, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit mbi migracionin e parregullt në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së, zbatimin e strategjisë dhe planin e veprimit për migracion, rishikimin e këtyre dokumenteve, nëse është e nevojshme të sigurohet veprim efektiv, zhvillimi i bazës së të dhënave për migracion dhe sigurimi i qasjes për të gjitha autoritetet e përfshira në menaxhimin e migracionit, krijimi dhe aplikimi i një mekanizmi për monitorimin e lëvizjeve së migracionit, definimi dhe aplikimi i një metodologjie për zbulime brenda vendit dhe përmirësimi i kapaciteteve të autoriteteve kompetente në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe lehtësimin e migracionit të parregullt, vendosja e një procedure të përshtatshme për dëbimin dhe largimin efektiv nga Kosova të shtetasve të vendeve të treta me qëndrim ilegal, mbajtja e programeve trajnuese lidhur me kundër-korrupsionin dhe vendosja e një kodi të etikës për zyrtarët e përfshirë në politikën e migracionit, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme për ofrimin dhe lëvizjet e migracionit legal dhe të parregullt te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it, shqyrtimi i mënyrave të bashkëpunimit me iniciativat rajonale për migracionin, azilin dhe refugjatët.

Azili - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: harmonizimi me *acquis* të BE-së dhe zbatimi i legjislacionit mbi azilin, fuqizimi i kapaciteteve të autoriteteve kompetente në përmbushjen e detyrave të tyre, garantimi i pavarësisë dhe ngritjes së kapaciteteve të autoriteteve mbikëqyrëse të ngarkuara me azilin, mbajtja e programeve të trajnimit lidhur me kundër korrupsionin dhe të vendos një kod të etikës për zyrtarët e përfshirë në politikën e azilit, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme për azilin tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it, shqyrtimi i modaliteteve të bashkëpunimit me EASO.

BLLOKU 3: Siguria dhe rendi publik Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë shpëlarjen e parave, dhe krimit financiar, konfiskimin dhe kthimin e asetëve, si dhe financimin e terrorizmit, në pajtim me *acquis* të BE-së, duke siguruar se ndryshimet në këtë legjislacion po ashtu janë reflektuar në kodin penal, miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve, në pajtim me *acquis* të BE-së, sigurimi i hetimeve dhe ndjekja proaktive e trafikimit me qenie njerëzore, duke përfshirë dënimet bindëse për individët që janë shpallur fajtorë në këtë krim serioz, miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit më narkotikë dhe prekursorë, në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së, zbatimi i strategjisë dhe planeve të veprimit për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me droga dhe prekursorë, kundër terrorizmit, parandalimit të krimit dhe trafikimit me armë, realizimi i hetimeve proaktive të pasurisë së pazakonshme/të dyshimtë, fuqizimi i kapaciteteve të policisë dhe njësisë përgjegjëse për inteligjencë financiare për të kryer në mënyrë efektive dhe të pavarur hetime komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, fuqizimi i kapaciteteve të policisë për zbulim dhe hetim, prokurorëve për ndjekje dhe gjyqtarëve për gjykim, përmirësimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave dhe inteligjencës kriminale ndërmjet autoriteteve për zbatim të ligjit dhe atyre gjyqësore, zbatimi i legjislacionit ekzistues për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe fuqizimi i kapaciteteve të policisë për krijimin dhe funksionalizimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve, zhvillimi i një bazë të qëndrueshme të të dhënave për regjistrin e veprave penale, përfshirë në baza të asistencës reciproke ligjore për çështje penale, garantimi për zbatim efektiv dhe efikas të vendimeve të gjykatave, vendosja e mekanizmave efektivë për parandalimin e korrupsionit dhe për identifikimin dhe përcjelljen e rrezikut për korrupsion, shtimi i efikasitetit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, mbajtja e programeve trajnuese për kundër korrupsionin dhe krimin e organizuar, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it

Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim në fushën e zbatimit të ligjit, vendosja e zyrtarëve ndërlidhës për zbatim të ligjit në shtetet anëtare dhe vende të treta, rritja e nivelit të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda ndërkufitare, vendosja e një aranzhimi me EULEX-in për shkëmbim të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të informatave strategjike dhe operative dhe inteligjencë kriminale të nevojshme për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda, zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese me EULEX-in lidhur me shkëmbimin e të dhënave për çështje tatimore dhe doganore, garantimi se shkëmbimi i informatave për zbatim të ligjit, i kryer nëpërmes kanaleve përkatëse, funksionon në lidhje më të gjitha shtetet anëtare, shtimi i bashkëpunimit operacional me autoritetet e sundimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta, me theks të veçantë me anë të realizimit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta, përmirësimi i kapaciteteve hetuese të udhëhequra nga inteligjenca, të autoriteteve për sundim të ligjit për hetimin e krimeve të rënda ndërkufitare/kufirit administrativ, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme lidhur me shkëmbimin e informatave në fushën e zbatimit të ligjit, hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta të autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it, shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim me EUROPOL, shqyrtimi i mënyrave të bashkëpunimit me EMCDDA, shqyrtimi i mundësive të bashkëpunimit me iniciativat rajonale për bashkëpunim në fushën e zbatimit të ligjit.

Bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale - Kosova duhet t'i përmbushë këto kushte: zbatimi i legjislacionin ekzistues për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale, zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim në çështje penale dhe ku është e mundshme të nënshkruaj marrëveshje të reja, miratimi dhe zbatimi i masave që kanë për qëllim përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe pavarësisë së bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale me shtetet anëtare dhe vendet e treta, zbatimi i marrëveshjes teknike me EULEX-in për ndihmë juridike reciproke, sigurimi se bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale, i realizuar nëpërmes kanaleve përkatëse, funksionon në lidhje me të gjitha shtetet anëtare, hartimi dhe komunikimi me kohë i statistikave të hollësishme për rastet e bashkëpunimit juridik në çështje penale të autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it, shqyrtimi i mundësisë së bashkëpunimit me EUROJUST.

Mbrojtja e të dhënave - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: harmonizimi me *acquis* të BE-së dhe të zbatojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, garantimi i pavarësisë dhe fuqizimi i kapaciteteve të autoritetit për mbrojtjen e të dhënave, mbajtja e programeve trajnuese lidhur me kundër korrupsionin dhe vendosjen e një kodi të etikës për zyrtarët e autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale.

BLLOKU 4: Të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes

Liria e lëvizjes - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: sigurimi që liria e lëvizjes e qytetarëve të Kosovës nuk i nënshtrohet kufizimeve të paarsyeshme, duke përfshirë edhe masat e natyrës diskriminuese, të bazuar në çfarëdo baze si gjinia, raca, ngjyra, etnia ose origjina sociale, tipare gjenetike, gjuha, besimi ose religjioni, mendimi politik ose ndonjë mendim tjetër, përkatësia e një grupi minoritar, lindja, aftësitë e kufizuara, mosha ose orientimi seksual.

Kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve identifikuese - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: sigurimi se të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë femrat, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat që i përkasin një minoriteti dhe individëve të cenueshëm kanë qasje të plotë dhe efektive në dokumentet personale të udhëtimit dhe identifikuese, përfshirë regjistrimin civil. Sigurimi i qasjes së plotë dhe efektive në dokumente personale të udhëtimit dhe dokumente identifikuese për personat e zhvendosur, refugjatët dhe të kthyerit.

Të drejtat e njeriut dhe respekti dhe mbrojtja e minoriteteve - Kosova duhet t'i përmbush këto kushte: sigurimin se të gjitha dispozitat vendore për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve respektohen plotësisht, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit që përcakton mbrojtje efektive kundër diskriminimit, sigurimin se legjislacioni relevant për përcaktimin e kushteve dhe rrethanave të marrjes së shtetësisë së Kosovës zbatohet në mënyrë të kënaqshme, sigurimi që incidentet e motivuara etnikisht të kryera në fushën e lëvizjes së lirë, duke përfshirë ato incidente që kanë për qëllim persona me përkatësi nga minoritetet, do të hetohen plotësisht, miratimi dhe zbatimi i masave drejt shtimit të integritetit efektiv të personave që i takojnë minoritetit serb, rom, ashkali, egjiptas, boshnjak, turk dhe goran të Kosovës.